BASHKIA FIER

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE I VITIT 2024**

| Nr. rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigja | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 04.01.2024 | Për mbrojtjen e konkurencës kërkojmë të informohemi me Vendimin e Këshillit Bashkiak të Fierit mbi caktimin e çmimeve në shërbimin taksi në varësi të distancës dhe kohës së shërbimit | 08.01.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me email për shkresën nr.14 prot, datë 04.01.2024 të Autoritetit të Konkurencës | https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-fier-nr50-date-03-12-2015/ | Pa pagesë |
| 2 | 08.01.2024 | Informacionin mbi proçesin e konsultimit të PBA 2024-2026 si dhe Buxhetit 2024 konkretisht:-Sa organizata/grupe interesi janë njoftuar për konsultim; -Sa aktorë kanë marrë pjesë në konsultim; -Komentet e paraqitura [nëse janë marrë ose në shqyrtim]; -Informacion mbi buxhetimin gjinor [ku dhe sa është përfshirë në programet buxhetore]; -Minutat e takimit takimit të sesioneve të konsultimit publik, si dhe çdo informacion tjetër relevant në lidhje me këtë proçes | 16.01.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me email për shkresën nr.91 prot. | https://bashkiafier.gov.al/buxheti/ | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 09.01.2024 | Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit ose kopje kërkesës A.Gj. Për 1-Kopjen fillestare të lejes së ndërtimit nr.5, datë 13 gusht 2004. 2-Marrje në dorëzim të objektit (pallat), të lejes së sipërpërmendur, që ka ndërtuar firma e ndërtimit *"Gjini'*' shpk 3-Kohën kur insitucioni juaj ka dërguar dokumentacionin përkatës (lejen e ndërtimit, regjistrimin e objektit) në ASHK-në Fier, ndërtuar nga firma *"Gjini"* shpk. 4-Emërtimin zyrtar për objektin e ndërtuar në këtë adresë, rruga *"Todi Shkurta"* , nd.9, h.17 | 31.01.2024<br>06.02.2024 | Përfunduar. U dhanë informacioni dhe kopje me shkresat nr.230/1 dhe nr.1276/1 prot. | Kopje lejes së ndërtimit nr.5, datë 13.08.2004, të KRRT-së Bshkisë Fier, objekti 1kat bodrum+1kat lokal shërbimi+8kate banim. Ndonëse nuk është paraqitur ndonjë dokument identifikimi dhe asnjëherë në zyrën e informimit, qytetarit i është dhënë informacioni edhe për adresën sipas sistemit elektronik GIS, e cila rezulton e tillë qytetit Fier 9302, rruga *"Todi Shkurta"* , numri ndërtesës 9, hyrja 17 kati 9 ap 56 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 12.01.2024 | Në kuadër të hulumtive në nivel kombëtar të informohemi 1-Sa është shuma vjetore e shpenzuar nga Bashkia juaj për vitin 2023 për hostimin, domainin dhe shërbimet e faqes zyrtare web? 2-A ka bashkia juaj një program të miratuar transparence dhe nëse po, kur është miratuar ai? 3-Sa është numri i kërkesave për informim që kanë ardhur vetëm elektronikisht në bashkinë tuaj? Nëse mundeni apo keni një informacion të përgjithshëm, sa ka qënë numri i vizitorëve të faqes web të bashkisë gjatë vitit 2023 | 25.01.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me e-mail. | 1-Shuma vjetore e shpenzuar nga Bashkia Fier, për vitin 2023, për hostimin, domainin dhe shërbimet e faqes zyrtare elektornik web, është *0 (zero)* lekë. 2-Bashkia Fierit, në vitin 2019, e ka miratuar Programin e Transparencës sipas rekomandimit të Komisionerit. 3-Numri i kërkesave për informim të ardhura vetëm elektronikisht është *7(shtatë)* . 4-Numri i vizitorëve të faqes elektronike web të Bashkisë Fier për vitin 2023, është 3270. | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 25.01.2024 | Informacion mbi qytetarin I.Y. i cili trajtohej me PAK, qysh nga viti 1998 deri më 30 nëntor 2023 dhe pas nëntorit 2023 i është ndërprerë kempi! Qytetari jeton i vetëm pasi i ka humbur të gjithë familjarët. Si duhet të trajtohet ky qytetar? A ka Bashkia institucione pritëse? Çfarë zgjidhje afron? | 02.02.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me e-mail për kërkesën nr.837 prot. | Qytetarit I. Y. i është ndërprerë pagesa e paaftësisë, pasi dosja ndodhet për rikomisionim në Komisionin Bio-psiko Social. Deri në vlerësimin e Komisionit dhe dërgimin e vendimit pranë Njësisë Administrative, nuk mund të paguhet. Me ardhjen e këtij vendimi do të paguhet sipas afateve dhe grupit që përcakton ky Komision. Sa i takon sistemimit të kësaj kategorie në institucione pritëse, Bashkia Fier nuk ka qendër të tillë për akomodimin e këtyre personave. Për sqarim plotësues, mund t`i drejtoheni Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier. | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 25.01.2024 | Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit për kërkesën e A.Gj. Mbi vlerësimin e institucionit për statusin *"I strehuar"* apo *"I pastrehë"* për qytetarin A.Gj. | 12.02.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.936/1 prot. | Mbi vlerësimin e statusit *"I strehuar"* apo *"I pastrehë"* për shtetasin A.Gj. ju informojmë se çdo familje e pastrehë e cila kërkon të trajtohet nga programet e strehimit social, bazuar ne ligjin nr.22/2018 *"Për strehimin social"* i ndryshuar, si dhe VKM nr.384 , datë 12.06.2019 *"Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore",* aplikon nëpërmjet sistemit online në portalin e-albania, për të vijuar me pas procedurat administrativo-ligjore nga strukturat përgjëgjëse në zbatim të përcaktimeve ligjore, në mënyre që familja e pastrehë të kualifikohet me statusin *"e pastrehë"* konform dispozitave | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 31.01.2024 | Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit ose kopje për kërkesën e A.R. Mbi dëmet në pyje (2020-2023): 1- Sa ka qënë sipërfaqja dhe volumi i prerjeve të paligjshme të drurëve? 2-Sa ka qënë sipërfaqja e djegur plotësisht? 3- Sa ka qënë volumi i djegur plotësisht? 4- Sa ka qënë volumi i djegur, por ende i papërdorshëm? 5-Sa ka qënë numri i zjarreve? 6-CIlat kanë qënë shkaqet e zjarreve? 7-Cili ka qënë dëmi financiar i shkaktuar nga djegia? 8-Cilat zona u prekën nga zjarre? Mbi shfrytëzimin e pyjeve (2020-2023): 1-Sa ka qënë sasia e shfrytëzuar e lëndës drusore për zjarr lëndë punuese dhe qymyr? 2-Sa ka qënë sipërfaqja e pakësuar nga ndryshimi i fondit pyjor për projekte HEC etj? 3-Sa është shuma totale e shpenzimeve për mirëmbajtje të fondit? Mbi të ardhurat e siguruara nga fondi pyjor dhe kullosor (2020-2023): 1- Cila është shuma totale e të ardhurave të siguruara nga prodhimet pyjore? 2-Cilat janë ekonomitë pyjore në bashkinë tuaj? 3- Sa është numri i plazheve të licensuara në ekonomi pyjore? 4-Cilat janë zërat kryesorë të të ardhurave nga fondi? 5-A tregtoni lëndë drusore në bashkitë e tjera? 6- A keni parqe bashkiake territore (monumente) natyrore të cilat gëzojnë | 21.02.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.1076/1 prot. | **Mbi dëmet në pyje;** 1- Për vitet 2020-2021 nuk kemi pasur prerje të paligjshme, për vitin 2022 kemi pasur vetëm 2 raste dhe sasia ka qënë tek 3m³, ndërsa për 2023 kemi pasur 3 raste me sasinë prej 2m³. 2- Sipërfaqja e djegur plotësisht nga zjarri për vitin 2020 ka qënë 14ha, për vitin 2021 ka qënë 13.5ha, për vitin 2022 ka qënë 3.5ha dhe për vitin 2023 ka qënë 195.5ha. 3- Volumi i djegur për vitin 2020 ka qënë 14m³, për vitin 2021 ka qënë 13.5m³, për vitin 2022 ka qënë 120m³ dhe për 2023 është 54829m³. 4- Volumi djegur por i përdorshëm për vitin 2020 dhe vitin 2021 nuk ka, për vitin 2022 është 100m³ dhe për vitin 2023 nuk kemi një vlerësim të saktë momentalisht. 5- Numri i zjarreve për 2020 ka qënë 12, për vitin | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | 05.02.2024 | Informacion nga Plani i Përgjithshëm Vendor për zonën kadastrale 8531, pasuria nr.3/840 | 09.02.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.1208/1 prot. | Pasaporta:**Nr.249,** Kodi 1/46; Përdorimi bazë:**A.Banim**; Kategoria 1 100%; Kat2 0% dhe Kat3 0%; Përdorime të tjera:**Janë të gjitha ato që nuk janë të ndaluara ose kushtëzuara;** Të ndaluara: ***Industri, ekonomi, ushtarake, përveç magazinave jo ndotëse.*** Tipologjia:**Vila;** *Nuk ka* ***Plan Rrugor*** *dhe* ***PDV.*** Lartësia maksimale (në m) 20, në kate 6 | Pa pagesë |
| 9 | 05.02.2024 | Kopje të vendimit nr.47, datë 29.02.1998 të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave për kthimin fizikisht të pyllit zotit Shaban Hoxhën | 21.02.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.1209/1 prot. | Nuk disponohet vendimi | Pa pagesë |
| 10 | 08.02.2024 | Informacion ose kopje të vendimeve të Këshillit Bashkiak apo të Kryetarit të Bashkisë, të vitit 2005, për mos lejimin e legalizimeve. | 21.02.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.1364/1 prot. | Nuk ka ndonjë vendimmarrje, të vitit 2005, për mos lejimin e legalizimit | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | 08.02.2024 | Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 78, datë 21.09.2023 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"* , janë forcuar edhe më tej rregullat, mekanizmat dhe procedurat për njohjen me informacion/dokumentacion me karakter publik nga qytetarët. Bazuar në pikën **2 të nenit 24/1** të ligjit të sipërcituar *"Autoritetet publike raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 31 e muajit janar të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri".* Për sa më sipër, ju lutem plotësoni pyetësorin e mëposhtëm brenda ditës së sotme në tabelën në excel të cilën e gjeni bashkëlidhur. | 13.02.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me e-mail | 1-Kërkesat për informacion publik të regjistruara në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve nga koordinatori për të drejtën e informimit për periudhën janar- hjetor 2023 janë **18**. 2-Kërkesat që janë dërguar për trajtim tek koordinatori i një autoriteti tjetër janë **2***(dy)* . 3-Kërkesat që kanë marrë përgjigje të plotë janë **12**. 4-Kërkesat që kanë marrë përgjigje të pjesshme, janë **4**. 5-Kërkesat e konsideruara jashtë objektit të ligjit për të drejtën e informimit por janë trajtuar si detyrë funksionale e autoritetit publik janë **0**(zero). 6-Kërkesa të pezulluara janë **0**(zero). 7-Kërkesa e refuzuara janë 2(dy). 8-Arsyet e dhënies së pjesshme të përgjigjeve ose e refuzimit të | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | 12.02.2024 | Kopje të lejes së ndërtimit nr 2371/4, dt 14.12.2022 | 21.02.2024 | Përfunduar. U dha kopje me shkresën nr.1463/1 prot. | Leje së ndërtimit nr.2371/4, datë 14.12.2022, dhe të Vendimit nr.289, datë 14.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Fier për objektin *"Rrethim me mure i pronës"* | Pa pagesë |
| 13 | 15.02.2024 | Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit ose kopje për kërkesën e Qendrës Respublica: Sa është shuma e paguar për konsumin e energjisë elektrike për periudhën 01.10.2021-2023? (të ndara sipas muajve) | 21.02.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.1622/1 prot. | Shuma e paguar për konsumin energjisë elektrike për institucionin e Bashkisë Fier, për periudhën **01.10.2021–20.10.2023**, është 1032636,80 lekë. Të ndarë sipas muajve **viti 2021**: Tetor 48433,60 lekë, Nëntor 64242,00 lekë, Dhjetor 43242,40 lekë; **viti 2022:** Janar 48752,80 lekë, Shkurt 47824,40 lekë, Mars 33246,40 lekë, Prill 18311,20 lekë, Maj 24913,60 lekë, Qershor 26056,00 lekë, Korrik 28945,60 lekë, Gusht 31717,60 lekë, Shtator 33901,60 lekë, Tetor 36186,40 lekë, Nëntor 29281,60 lekë, Dhjetor 47442,40; **viti 2023**: Janar 35010,40 lekë, Shkurt 32994,40 lekë, Mars 24880,00 | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | 15.02.2024 | Kopje të dokumentacionit të lejes së ndërtimit të shkollës 8-vjeçare *"Flatrave të Dijes"* në Sheqin e Vogël | 26.02.2024 | Përfunduar. U dha kopje me shkresën nr.1666/1 prot. | Kopja lejes së ndërtimit nr.6, datë 31.01.2022. si dhe të të studimit urbanistik nr.6, datë 31.01.2002, të KRRT-së Komuna Qendër Fier, objekti shkollë 8-vjeçare 4kate. | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | 22.02.2024 | Kërkesë për informacion Bashkia në proçeset e integrimit evropian: 1-Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtaritë e bashkisë në kuadrin e integrimit në BE; Bashkia dhe shoqëria civile: 2-Në trësi të dhënat dhëna për grupet e interest. 3-Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit. 4-Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme. 5-Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile. Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. 6-Emër mbiemër. 7-Adresa postare/elektronike të tij. Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje: 8-Aktet që janë konsultuar/do të konsultohen në vitin 2023-24. 9-Mënyrat e konsultimit. 10-Afatet.Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje në vitin 2024; 11-Projektakti, relacioni shpjegues dhe dokumentat shoqërues të tij. 12-Arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimin që ai do të ketë. 13-Afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre; 14-Adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultmit publik të bashkisë ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të | 06.03.2024 | Përfunduar. U dha informacioni e kopje të akteve, relacioneve dhe dëgjesave me e-mail. | 1- Në kuadër të proceseve të integrimit evropian Bashkia Fier, për vitin 2023, ka aplikuar në disa projekte dhe ka fituar projektin "Romancted", i cili është një projekt i BE-së dhe ka në fokus komunitetin rom. Ky projekt është në implementim të sipërt. Edhe në vitin 2024 ka patur disa aplikime, është fituar projekti nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për ngritjen e një qendre rinore dhe jemi në pritje të nënshkrimit të kontratës. Për vitin 2023 Bashkia e Fierit ka realizuar disa aktivitete në kuadër të integrimit evropian si: Aktiviteti në Shkollën 9-vjeçare "Thanas Ikonomi" në Grecalli, **Urimi i Bashkisë për Javën e Evropës**; Takimi në Zyrën Rajonale të K.M.D.-së (namofobia). Gjithashtu në ambientet | Pa pagesë |
| 16 | 28.02.2024 | Kopje të lejes së ndërtimit, nr.1, datë 22.03.1999, në emër të P.V. | 01.03.2024 | Përfunduar. U dha kopje me shkresën nr.2118/1 prot. | Leja e ndërtimit nr.1, datë 22.03.1999 e KRRT-së Bashkia Fier, objekti market+banesë 4kate | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | 11.03.2024 | Kopje të kontratave të punës në pozicionin, kuzhinjere në Kopshtin nr.5, Kopshtin Nr.8, dhe në Kopshtin Nr.6 | 21.03.2024 | Përfunduar. U dha informacioni nr.2594/1 prot. | Dërguar për trajtim tek një sektor/autoriteti tjetër | Pa pagesë |
| 18 | 20.03.2024 | Kopje të lejes së ndërtimit nr.5, datë 07.06.2002 të KRRT së Bashkisë Fier | 27.03.2024 | Përfunduar. U dha kopje me shkresën nr.2847/1 prot. | Leja e ndërtimit nr.5, datë 07.06.2002 e KRRT-së Bashkia Fier, objekti shtesë pallati 5katësh | Pa pagesë |
| 19 | 05.04.2024 | Të dhëna nga Plani i Përgjithshëm Vendor për zonën kadastrale 2636, pasuria 36/26, Mbrostar Ura | 24.04.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.3397/1 prot. | Përdorimi bazë: **Banim, bujqësi, shërbime bujqësie, Infrastrukturë.** Përdorim i kushtëzuar: Karburant; Kate ndërtimi: **2 kate**. **Nuk ka plan rrugor. Nuk ka PDV** | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 20 | 11.04.2024 | Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit ose kopje për kërkesën D.Xh,: 1-Lista e gjithë pronave të palautshme që zotron Bashkia Fier, ku të jenë përcaktuar gjithë të dhënat për secilën pronë, përfshit vendodhjen e secilës prej tyre. 2-Kopje të gjithë kontratave të dhënies me qira të pronave të paluajtshme që zotron Bashkia Fier (ku Bashkia është në rolin e qiradhënësit). 3-Kopje të gjithë kontratave të marrjes me qira të pronave të paluajtshme nga ana e Bashkisë Fier (ku Bashkia është në rolin e qiramarrësit) | 18.04.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.4181/1 prot. | 1-Iventarizimi i të gjithë pronave të paluajtshme të Bashkisë Fier është një proces i dinamik që pasurohet herë pas here nga vendimet e qeverisë dhe të Këshillit Bashkiak Fier. Lista e këtij iventari fillon me tranferimin e bërë nga qeveria me VKM nr. 574/2009, me VKM nr.770/2007, me VKM nr.363/2009, me VKM nr.375/2011, me VKM nr.456/2011, me VKM nr.509/2011, me VKM nr.901/2011, me VKM nr.854/2012, me VKM nr. 207/2018, të cilat janë publike në faqen zyrtare elektronike të Bashkisë Fier, linkun: https://bashkiafier.gov.al/pronat-dhe-asetet/, si dhe në vendimet e Këshillit të Bashkisë Fier, nga viti 2015 e deri më sot, https://bashkiafier.gov.al/vendime.al/ 2- E drejta e pronësisë ushtrohet | Pa pagesë |
| 21 | 16.04.2024 | Kopjes të njëhsuar të vendimit nr.171, datë 05.10.1995 të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Fier | 24.04.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.4369/1 prot. | Nuk disponohet vendimi, pasi Arkiva e Bashkisë Fier është djegur në vitin 1997. | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 22 | 22.04.2024 | Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit ose kopje për kërkesën V.D: 1-Kur e ka marrë në administrim bashkia inceneratorin e Fierit dhe cila është baza ligjore për këtë kalim administrimi? 2-A është vënë në funksion të plotë inceneratori i Fierit duke përfshirë edhe djegien e mbetjeve më pas prodhimin e energjisë elektrike? 3-Kur pritet të fillojë djegia e mbetjeve në incenerator? 4-Janë bërë shkarkime punonjësish dhe me çfarë motivacioni? 5-A ka kapacitet landfilli i Inceneratorit për depozitimine mbetjeve dhe për sa kohë? 6-Sa është sipërfaqja e disponueshme për depozitim mbetjesh në landfill? 7-Sa punonjës ka aktualisht në incenerator dhe a i kanë nënshkruar kontratat e punës me bashkinë? 8- Bashkitë e tjera të qarkut a marrin pjesë në administrimin e inceneratorit dhe si? 9-CIlat bashki i kryejnë derdhje mbetjesh në landfillin e inceneratorit dhe sa tonë përkatësisht? 10-Me qëllim informimi dhe korrektësie dua të filmoj ose fotografoj landfillin në një ditë dhe orar të caktuar bashkarisht. | 25.04.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.4542/1 prot. | Zyra e shtypit dhe Ndërmarrja e Pastrimit të Bashkisë i ka dhënë përgjigje nëpërmjet telefonit qytetares për sa ka kërkuar, duke e sqaruar që Bashkia e Fierit nuk e ka marrë në administrim Inceneratorin e Fierit se ky objekt është në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), Tiranë.1-Bashkia Fier nuk e ka marrë në administrim Inceneratorin e Fierit. Inceneratori është në administrim të (AAPSK) Tirane. Për pyetjet 2, 3, 4, 6 dhe 7 qytetarja duhet t`i drejtohet (AAPSK). 5.-Në këndvështrimin e Bashkisë Fier, landfilldi i Inceneratorit ka kapacitet për depozitim mbetjesh. Lidhur me kohëzgjatjen, përgjigjen e merr tek (AAPSK), Tiranë. 8-Në | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 23 | 22.04.2024 | 1-Kopje të propozimin e me shkrim të 1/3-s të këshilltarëve për shkarkimin e Zv.Kryetarit të Këshillit Bashkiak Fier. 2-Arsyetimin e Komisionit të Mandateve të Këshillit Bashkiak Fier për shkarkimin e Zv.Kryetarit të Këshillit. 3-Procesverbalin e mbledhjes dhe çdo regjistrim video dhe audio të saj. | 30.04.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.4557/1 prot. | 1- Propozimi i 1/3 së anëtarëve të Këshillit Bashkiak për shkarkimin e Zv.Kryetarit është vënë në dispozicion në mbledhjen e Kryesisë së K.Bashkiak, më datë 23.04.2024. 2-Arsyetimi i Komisionit të Mandateve u komunikua gjatë mbledhjes së K.Bashkiak të datës 26.04.20224. 3-Procesverbali i mbledhjes së K.Bashkiak i është vënë në dispozicion sapo është firmosur nga 5 këshilltarët sikurse e kërkon rregullorja. Regjistrime video-audio nuk posedohet ana e Sekretarisë së Këshillit. 4-Procesverbali i Komisionit të Votimit, fletët e votimit dhe vendimi për shkarkim e Zv.Kryetarit ndodhen në Zyrën e Arkiv-Protokollit lehtësisht të aksesueshëm nga ana çdo këshilltari. | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 24 | 16.05.2024 | Kopje të lejeve të dhënë për punime mirëmabajtje të zakonshme të banorit të katit të pestë A.Gj. ose K.Gj. | 05.06.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.5416/1 prot. | Pranë sporteleve të Zyrës me Një Ndalesë është paraqitur K.Gj. me dokumentacionin e nevojshëm (çertifikatë prone, fotografitë e vendriparimeve dhe kartë identiteti) dhe ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit për Fillim Punimesh të Mirëmbatjes së Zakoshme brenda apartamentit, përkatësisht më datë 04 nëntor 2020, me nr.9073 dhe më datë 09 qershor 2021, me nr.5293prot. | Pa pagesë |
| 25 | 16.05.2024 | A është në listën e iventarit të pronave të Bashkisë Fier, pasuria nr.17/12 ZK 2772, tokë/trualli përreth apartamentit ndohur në fshatin Ndërnënas, Njësia Administrative Libofshë? Nëse po, ju lutemi si mund të blihet? | në proçes | kërkesa nr.5424 prot. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 26 | 21.05.2024 | Kopje të projektit të lejes së ndërtimit nr.71, datë 23.03.2023. | 30.05.2024 | Përfunduar. U dha kopje me shkresën nr.5592/1 prot. | Leja e Ndërtimit nr.71, datë 23.03.2023 e Kryetarit të Bashkisë për objekt banimi dhe shërbimi me 5kate. 1kat nëntokë+1kat shërbim+4 kate banimi. | Pa pagesë |
| 27 | 22.05.2024 | 1-Çfarë kontrate keni lidhur ju me zotin N.H.? nëse po, lutemi na vini në dispozicion një kopje të saj. 2-Pse ka lindur nevoja që të bashkëpunini me këtë person? 3-Kur e ka marrë me qira këtë objekt zoti N.H. dhe për çfarë e përdor? 4-Pse nuk i trajtoni vetë mbetjet urbane? 5-Nga vëzhgimi që kryem mësuam që ky person i shet këto mbejte në një pikë skrapi në Tiranë. | 22.05.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me intervistë për kërkesën nr.5679 prot. | Bashkia Fier nuk ka kontratë të lidhur me ndonjë qytetar, ndërsa pika (tek ish-Azotiku) ka karkater grumbullimi të mbetjeve urbane të cilat më pas dërgohen në landfill. | Pa pagesë |
| 28 | 23.05.2024 | Segmenti rrugor Feir-Levan a ndodhet ne iventarin e ARRSH-së | 19.04.2024 | Përfunduar. U dha kopje me shkresën nr.5727/1 prot. | Eshtë pronë e Autoritetit Rrugor Shqiptar. | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 | 29.05.2024 | 1-Sa dëgjesa dhe konsultime publike janë kryer në Bashkinë Fier gjatë periudhës shtator 2023-maj 2024? 2-A janë kryer publikime në regjistrin elektronik të projekt-aktit, të njoftimitë konsultimit dhe të dhënat e konsultimit? 3-A janë kryer publikime në programin e transparencës të planit vjetor të organeve publike që lidhen me proçesin e vendimmarrjes? 4-Cilat janë rrugët e përdoruara nga ana e Bashkisë Fier për të kryer njoftimet gjatë proçesit të konsultimit publik dhe për të garantuar pjesëmarrjen e gjerë të komunitetit dhe gjithëpërfshirjen? 5-A kanë dhënë rezultat këto mënyra njoftimi në afrimin e komunitetit në këto proçese? 6-Sa ka qënë pjesëmarrja e komuitetit (numër) për çdo konsultim/dëgjesë publike? 7-Në të gjitha fazat e këtij proçesi është e nevojshme shpërndarja, publikimi dhe dhënia e informacioneve duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrjae komentave dhe rekomandime për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri tek miratii i aktit përfundimtar. për këtë na nevojiten kopje të të projekt-akteve të shoqëruar me përmbledhje të rekomandimeve dhe arsyet e palëve të interesuara. 8- A ka patur ankesa për projekt-akte? nëse po | 12.06.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.5938/1 prot. | 1-Gjatë periudhës shtator 2023-maj 2024 janë kryer 4 konsultime publike në Bashkinë Fier. 2 konsultime i përkasin vitit 2023, përkatësisht dokumenti *"Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024"* dhe *"Për miratimin e Buxhetit të Bashiksë Fier për vitin 2024 dhe numri të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Fier për vitin 2024"*. Ndërsa deri në maj të viti 2024 konsultimet këtyre dokumenteve *"Për miatimin e Planit Vendor Social të Strehimit për vitin 2023-2028 të Bashkisë Fier"* dhe *"Për miratimin e Planit të përmirësimit të arsimit parashkollor 2024-2026"* të Bashkisë Fier". 2- Publikime mbi këto kunsultime publike të njoftimeve janë kryer në faqen zyrtare elektronike | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 30 | 05.06.2024 | 1-Sa është numri i stacioneve të MZSH në bashkinë tuaj? 2.Sa është numri total i makinave zjarrfikëse në bashkinë tuaj ? 3.Sa është numri i efektivëve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ( zjarrfikës dhe punonjës)?. 4. Cilit vit i përkasin automjetet zjarrfikëse dhe a mund të specifikoni nëse janë blerë nga fondet e bashkisë apo donacionet? 5. A ka Bashkia plane afatshkurtra për blerje mjetesh të reja apo investime lidhur me këtë program? | 14.06.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me email për kërkesën e ardhur elektronikisht. | 1-Numri i stacioneve të MZSH në Bashkinë Fier është **një**. 2-Numri i përgjithshëm i makinave zjarrëfikëse është **pesë**. 3-Numri efektivëve mbrojtës nga zjarri është **njëzet e shtatë.** 4-Makinat zjarrëfikëse i përkasin përkatësisht viteve 1970, 2003, 2011, 2021 dhe 2023 dhe janë donacione. 5-Bashkia Fier nuk ka ndonjë plan afatshkurtër për blerje mjetesh të reja. | Pa pagesë |
| 31 | 05.06.2024 | 1-A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 vjec;) për periudhën janar -dhjetor 2023? Nëse po, sa % shumës totale të buxhetit zënë këto zëra? Nëse jo ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë? 2-Sa është numri total i punonjësve në Bashkinë tuaj (2023)? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 3-Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë tuaj në vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara edhe sipas gjinisë? 4-Sa është numri i të rinjve (18-29) të punësuar në bashkinë tuaj, të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse? | 18.06.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me email për kërkesën nr.6229/1 prot. | 1-Fondi për të rinjt ka qënë i integruar në buxhetin e Drejtorisë së Artit të Kulturës (DAK) me vlerë prej **13 920 000** lekësh. 2-Numri total i punonjësve në Bashkinë, për vitin 2023, është **1572,** prej tyre **613** femra, **835** meshkuj dhe nuk kemi me aftësi të kufizuar. 3-Numri i të rinjve *(18-29 vjeç)* punonjës të Bashkisë për vitin 2023 është **66,** femra **35** dhe **31** meshkuj. 4-**Nuk ka** të rinj *(18-29 vjeç)* që mbajnë pozicione drejtuese dhe | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 32 | 12.06.2024 | Informacion mbi arsyet e ndërprerjes së punimeve në disa nga rrugët e lagjes "1 Maj" | 13.06.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me email për kërkesën nr.6443/1 prot. | 1-Punimet për rikonstruksionin e rrugëve *"N.Kaçaku"* dhe *"Shëngjergji",* kanë filluar më dt.07.08.2023, por janë ndërprerë, me amendim kontrate me Sipërmarrësin sepse gjatë realizimit/zbatimit të projektit prekeshin pronat e qytetarëve. U ngrit Komisioni për vlerësimin e shpronësimevet dhe u përcoll dokumentacioni për miratim VKM në qeveri. 2- Po në këtë segment rrugor u ndërtua edhe rrjetit i ri ujësjellësit një investim nga KFV (Banka Gjermane) i cili sapo përfundoi. | Pa pagesë |
| 33 | 18.06.2024 | Të dhëna nga Plani i Përgjithshëm Vendor për pasurinë nr.18/9 zk3436 | në proçes | kërkesa nr.6594 prot. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 34 | 20.06.2024 | Çfarë ështe bërë për trajtimin e rastit të familjes Kristo, banues në fshatin Pishë, anëtarët të cilës janë me probleme të shëndetit mendor? | 01.07.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.6696/1 prot. | Për rastin që trajtoni është i panjohur pasi asnjë nga anëtarët ë familjës Kristo, nuk kanë shprehur ndonjëherë shqëtësim. Në bashkëpunim më Drejtorinë Rajonale Shërbimit Social Fier, u ngrit grupi i cili vërifikoi në terren problemin dhë analizoi situatën. Ku u mbajt dhe një proces-vërbal. Problëmi i familjarëve ishte jo pamundësia për të mënaxhuar sjelljen e të birit, por shqetësimi së kush do të kujdeset për të,pas largimit nga jëta të dy prindërvë të moshuar. U kontaktua edhe më mjeken ë familjes, ku konfirmoi një gjëndje të qetë të të sëmurit. Shqëtësimi i evidentuar DRSHSSH Fier e cila e referon në DPSHSSH si strukturat përgjegjësë që merren me akomodimin në | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 35 | 24.06.2024 | Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit kërkesës së Res Publica për 1-Sa është buxheti total i Teatrit "Bylis" për vitin 2024? 2-Sa ky buxhet shkon për projekte artistike dhe sa administratë, organikën dhe mirëmbajtjen etj? 3-Sa shafqe janë prodhuar në vitin 2022, në vitin 2023 dhe sa janë planifikuar për vitin 2024? 4-Cilat janë shfaqet e prodhuara për vitin 2022 dhe vitin 2023 dhe sa bileta janë shitur për secilën shfaqe? | 12.07.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me email sipas shkresës nr.403 prot, 03.07.2024. të Drejtorisë së Artit dhe Kulturës. | 1-Buxheti total i Teatrit "Bylis" për vitin 2024 është **10 000 000 lekë.** 2-Buxheti është grupuar në fondin DAK. 3-Për vitin 2022 janë prodhuar 9 shfaqe 9sipas tabelës), për vitin 2023 ka qënë Festivali Ndërkombëtar i Aktrimit "Apollon", për vitin 2024, janë rivënë në skenë **4** shfaqe dhe planifikuar edhe **6** të tjera. 4-Në shfaqet e vëna për vitin 2022 janë shitur **20236 bileta,** ndërsa për vitin 2023 janë shitur **79 bileta.** | |
| 36 | 25.06.2024 | A është në listën e iventarit të pronave të Bashkisë Fier, pasuria nr.1/1226-A, ZK 8532, ndodhur në Njësinë Administrative Nr.2 | 05.07.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.6877/1 prot. | Ndodhet në iventarin e pronave të Bashkisë Fier. | Pa pagesë |
| 37 | 05.07.2024 | Informacion për arsyet e mopërfitimit të ndihmës ekonomike me gjithë aplikimeve e bëra në sistem nga janari 2024 deri qershor 2024. | 15.07.2024 | Përfunduar. U dha informacioni me shkresën nr.7224/1 prot. | ME vemendje të shtuar nga administratori është trajtuar me ndihmë ekonomike që në vitin 2018. Është penalizuar nga kontrolli për shka të kushteve të mire. Penalizii zgjat 6-muaj. Jemi në pritje nga sistemi për aplikimin e bërë në korrik, përgjigjen | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 38 | 16.07.2024 | Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit ose kopje për kërkesën A.R.: 1-Në ç`mënyrë bëhet grumbullimi, trajtimi dhe largimi I ujërave të ndotura që përdorin banorët në Njësinë Administrative Levan, në Njësinë Administrative Frakull dhe në Njësinë Administrative Cakran? 2-Nëse këto njësi (ose fshatra të veçantë të tyre) ekziston shërbimi i grumbullimit dhe i trajtimit të ujërave të ndotura, cilat janë funksionet e tij; çfarë teknologjie përdoret për trajtimin e këtyre ujërave dhe çfarë përmban konkretisht procesi i trajtimit të ujërave të ndotura (mekanik, biologjik, kimik...)? 3-Nëse teknologjia e mësipërme nuk ekziston, çfarë mënyre përdoret, në secilin prej fshatrave të këtyre njësive? | 22.07.2024 | U përcoll për trajtim në UKF me shkresën nr.7620/1 prot. | Përcillet pranë Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve sha Fier si enti që admiistron rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura, shtrirjen e tij dhe teknologjinë që përdoret për proceset e trajtimit të këtyre ujërave. | |
| 39 | 18.07.2024 | A është në listën e iventarit të pronave të Bashkisë Fier, pasuria nr.1/1463-A, ZK 8532, ndodhur në Njësinë Administrative Nr.2 | në proces | kërkesa nr.7693 prot. | | |